

Ftesë për pjesëmarrje

Edicioni III i Karvanit të Sipërmarrjes së Gjelbër në kuadër të Projektit NAGE!

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural në kuadër të Projektit “Rrjetëzim dhe Mbështetje për Ekonominë e Gjelbër” – NAGE do të zhvillojë në datën 27 Gusht 2021 aktivitetin “Karvani i Sipërmarrjes së Gjelbër III”. Këtë vit, Karvani i Gjelbër do të udhëtojë në fermën Grand Albanik në fshatin Ballaban, rrethi i Përmetit, 35 km nga qyteti i Përmetit në këmbët e malit Trebeshinë.

Qëllimi i aktivitetit është të nxjerrë në pah potencialin e ekonomisë së gjelbër si një mjet diversifikimi për të arritur fuqizimin socio-ekonomik të të rinjve dhe grave, si dhe të zbulojë dhe promovojë modelin e agroturizmit dhe ekostrehimit në zonat rurale. Pjesëmarrësit do të mikpritën dhe të vizitojnë fermën Grand Albanik dhe ekobujtinën e ndërtuar nga dy njerëz të pasionuar (Elona Bejo - arkitekte dhe burri i saj i ndjerë francez - inxhinier ndërtimi) sipas parimeve të ekonomisë së gjelbër dhe qarkulluese.

Aktiviteti do të zhvillohet gjatë datës 27 gusht sipas këtij programi:

Programi

- Më 27 gusht, në orën 8.00** të mëngjesit, nisja nga Pazarin e Ri i 20 pjesëmarrësve të Karvanit të Gjelbër. Pjesëmarrësit kryesisht të rinj ruralë të përfshirë në zhvillimin rural dhe çështjet e ekonomisë së gjelbër dhe qarkulluese, sipërmarrës të gjelbër, aktivistë ruralë, organizata anëtare të ANRD, OShC të tjera, donatorë etj. do të mbledhen para hotelit Jolly në Pazarin e Ri të Tiranës, nga ora 7.30 deri në 8.00 të mëngjesit. Pjesëmarrësit do të prezantojnë veten, qëllimin, agjendën e aktivitetit dhe pritjet e pjesëmarrësve.
- 8.00 -11.30 paradite.** Nisja e organizuar nga Tirana dhe mbërritja në fermën Grand Albanik në Ballaban në orën 11.30. Udhëtim i pjesëmarrësve me autobus duke respektuar distancën sociale dhe masat sanitare kundër Covid19. Gjatë udhëtimit, prezantimi i Projektit të Rrjetëzimit dhe Avokimit për Ekonominë e Gjelbër- NAGE, qëllimi i tij kryesor dhe objektivat specifike, rezultatet aktuale dhe ajo që pritet të arrihet deri në mbylljen e projektit në lidhje me përfshirjen e aktorëve lokalë në vendimmarrje dhe reformimin e proceseve të zhvillimit rural, si dhe rritjen e nivelit të rrjetëzimit dhe avokimit për integrimin e konceptit të ekonomisë së gjelbër.
- Nga ora 11.45 -12.30** Vizitë rreth agroturizmit dhe prezantimi në terren nga Elona Bejo e konceptit të fermës Grand Albanik në prani të më shumë se 20 të rinjve rurale nga e gjithë Shqipëria. Ajo do të ndajë me pjesëmarrësit përvojën e saj në drejtimin e aktivitetit të saj turistik që u ofron turistëve vendas dhe ndërkombëtarë një produkt turistik totalisht novator, duke zbuluar Shqipërinë autentike dhe njerëzit e saj jashtë qarqeve formale turistike. Ajo do t'u prezantojë pjesëmarrësve idenë e saj për të rritur diversifikimin e ekonomisë rurale lokale duke krijuar zinxhirë të shkurtër furnizimi që kanë të bëjnë me mbledhjen e frutave të freskëta të egra dhe ushqimeve tradicionale nga banorët vendas, kryesisht gra dhe të rinj, të cilat konsumohen nga vizitorët e Grand Albanik, (duke kontribuar në fuqizimin dhe punësimin e komunitetit lokal rural), si dhe një sërë aktivitete të gjelbërta jashtë dhe brenda që përfshijnë

permakulturë, ecje, hipizëm, rafting, kamping, piknik, gatim me të ftuarit etj. Gjithashtu pjesëmarrësit do të njihen me idenë e kuzhinës dhe dyqanit në fermë të furnizuara kryesisht me produkte bujqësore nga familjet e fermerëve nga zona përreth, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të kësaj zone malore që vazhdon të vuajë eksodin rural.

4. Nga ora 12.30 deri në 13.10 Prezantimi i pjesëmarrësve me konceptin e ekobujtinës Grand Albanik, sistemet e furnizimit, duke vizituar ndërtesën kryesore të fermës të rindërtuar me materiale natyrore dhe ekologjike si guri dhe druri, sipas parimeve të ekonomisë së gjelbër dhe qarkulluese. Gjithashtu, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të vizitojnë bio-butikun duke pasur mundësinë të shijojnë dhe të marrin në shtëpi ushqime lokale, erëza dhe mjaltë të mbledhura dhe përpunuara nga banorët vendas të zonave rurale, duke kontribuar në këtë mënyrë në rritjen e ekonomisë lokale.

5.13.10 - 14.30 Të ftuarit do të jenë pjesë e një dreke pune të përbashkët me produkte të freskëta nga zona ku do të diskutojnë dhe ndajnë përshtypjet dhe idetë e tyre në lidhje me përvojën e fermës Grand Albanik, si dhe mundësitë për përsëritje në zona të tjera rurale të Shqipërisë të konceptit të fermës ekologjike dhe zinxhirit të shkurtër të furnizimit. Fermerët dhe fermeret lokalë do t'u prezantojnë mysafirëve gatimet tradicionale vendase dhe përbërësit e tyre të prodhuar sipas parimeve të bujqësisë biologjike, si dhe do të japin informacion mbi mënyrat e qëndrueshme për të shfrytëzuar pasurinë e faunës dhe florës në zonat rurale përmes ringjalljes së kuzhinës tradicionale dhe prezantimit të asaj ndërkombëtare për të tërhequr turistë vendas dhe të huaj.

6. 14.30 - 16.30 Kohë pushimi në natyrë/ose ambientet e ekobujtinës dhe mundësi për rrjetëzim

7. 17.00 – Përshëndetjet e rastit dhe nisja e pjesëmarrësve, mbyllja e Karvanit të Gjelbër 2021. Mbërritja në Tiranë në orën 20.30.

Presim shprehjen e interesit tuaj në adresën info@anrd.al deri në datën 25.08.2021.